

TË DHËNA MBI PERIUDHËN KOHORE

2017-2021

Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri



Ky dokument është hartuar nga INSTAT me mbështetjen teknike të UNICEF-it në Shqipëri, ofruar përmes Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve. Kjo ndërmarrje është realizuar në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara Askush të mos Mbetet Pas (LNB), financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Mirënjohje për kontributin: Majlinda Nesturi, Olta Caca, Elda Muca, Blerta Muja, Vera Brecani, Anisa Omuri, Eriona Dhamo, Ledia Thomo, Deana Delaj, Altin Xhikneli, Rezarta Myrtollari



Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri

Të dhëna mbi periudhën kohore
2017-2021

Hyrje

Treguesit me fokus fëmijët (0-17 vjeç), adoleshentët (10-19 vjeç) dhe të rinjtë (15-29 vjeç), janë pjesë integrale e [Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2022-2026](#). Ky botim sjell në vëmendjen e të interesuarve një menu të zgjeruar të treguesve, duke siguruar një panoramë të larmishme nga fusha të ndryshme të të drejtave dhe mirëqenies së fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve.

Treguesit e publikuar bazohen mbi të dhënat e grumbulluara nëpërmjet anketave të ndërmarra nga INSTAT-i, si edhe nga sistemet e menaxhimit të informacionit të institucioneve shtetërore (të dhënat administrative). Kështu, kjo nismë do të ishte e pamundur pa bashkëpunimin e ngushtë të institucioneve shtetërore raportuese.

Paraqitja e ecursisë të treguesve ndër vite, përcjellë përmes grafikëve dhe shpjegimeve të shkurtra, mundëson interpretimin dhe lehtësimin e të kuptuarin të tyre. Shoqërues i këtij botimi është edhe [paneli/dashboard-i i treguesve i fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve](#), me një përmbajtje më të zgjeruar në tregues, vlera e vizualizime.

Ky botim përfaqëson pikënisjen e asaj që institucionet përgjegjëse shtetërore dhe jo-shtetërore që operojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve pritet të bëjnë, duke i vendosur këto statistika zyrtare në kontekstin e duhur. Përdorimi i tyre në kuadër planifikues, monitorues, vlerësues, do të luajë rol thelbësor në sjelljen e ndryshimeve konkrete në jetët e fëmijëve, adoleshenteve dhe të rinjve në vend.






Popullsia e Shqipërisë, më 1 janar 2021, rezulton 2.829.741 banorë, nga të cilët 579.203 janë fëmijë (0-17 vjeç). Si rezultat i rënies së popullsisë me 1,6%, gjatë pesë viteve të fundit (2017-2021), edhe numri i kësaj grupmoshe ka ardhur duke u zvogëluar, duke shënuar çdo vit mesatarisht 3% fëmijë më pak.

Pesha që zënë grupmoshat e popullsisë 10-19 vjeç (adoleshentë) dhe 15-29 vjeç (të rinj) ndaj popullsisë gjithsej, rezulton përkatësisht 12,4%, dhe 22,7%. Në krahasim me vitin 2017, pesha e këtyre grupmoshave është gjithashtu në rënie (Figura 1).

Figura 1: Fëmijë, adoleshentë dhe të rinj në raport me popullsinë gjithsej, 1 Janar 2017, 2021



Burimi: INSTAT


Në nivel qarku, pesha që zënë fëmijët rezulton më e lartë në Kukës (24,7% të popullsisë së qarkut), ndërsa më e ulëta në Vlorë (18,3%). Gjatë pesë viteve të fundit (2017-2021), numri i fëmijëve ka ardhur duke u ulur gradualisht në të gjitha qarqet, me uljen më të ndjeshme në Gjirokastrë dhe Berat (24% dhe 20% përkatësisht). Ndërsa Tirana dhe Durrësi kanë uljen më të vogël (përkatësisht 3% dhe 6%), krahasuar me fillimin e periudhës, ndihmuar kjo edhe nga prurjet e migrimit të brendshëm, që i ka kthyer tashmë në dy qarqet me përqendrimin më të lartë të popullsisë së vendit.

Projeksionet e popullsisë, të ndërtuara për vitet 2019-2031, tregojnë se, në vitin 2021 popullsia përkon me skenarin e rritjes së ulët, ku vdekshmëria dhe migrimi janë të larta, ndërsa lindshmëria e ulët. Projeksionet e popullsisë me këtë skenar, parashikojnë për një popullsi prej 2.841.549. Nëse do të ndiqet ky skenar, në vitin 2031 përqindja e grupmoshës 0-17 vjeç ndaj totalit të popullsisë, pritet të bjerë në 17,7%.

Gjatë vitit 2021, kanë lindur rreth 27.2 mijë foshnja (12% më pak se në vitin 2017), ndërsa kanë vdekur rreth 30.5 mijë individë. Si rrjedhojë, shtesa natyrore e popullsisë (diferenca midis lindjeve dhe vdekjeve), në këtë vit, është rreth -3.3 mijë banorë.

Në 2021, koeficienti bruto i lindjeve, që shpreh numrin e lindjeve të gjalla me popullsinë mesatare për 1.000 banorë të të njëjtit vit, ishte rreth 9,7, duke shënuar rënie krahasuar me vitin 2017, kur ishte 10,7 lindje për 1.000 banorë (Figura 2).


Figura 2: Koeficienti bruto i lindjeve, 2017-2021 (numër)



Burimi: INSTAT; Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

Në vitin 2021, raporti gjinor në lindje, që shpreh numrin e djemve të lindur të gjallë për 100 vajza të lindura të gjalla, ishte 108, duke pësuar një rënie me 3 nga 111 që shënonte në 2017 (Figura 3).


Figura 3: Raporti gjinor në lindje, 2017-2021 (numër)



Burimi: INSTAT; Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

Në 2021, lindshmëria te femrat 15-19 vjeçe ishte 12,1 foshnja të lindura për çdo 1.000 femra të kësaj grupmoshe. Ky tregues ka pësuar rënie krahasuar me vitin 2017, kur shënonte 16,3 për këtë grupmoshë (Figura 4).


Figura 4: Lindshmëria te femrat e grupmoshës 15-19 vjeçe (për 1.000 popullatë përkatëse), 2017-2021



Burimi: INSTAT; Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

Numri mesatar i viteve që një i porsalindur sot pritet të jetojë (viti 2021), nëse vazhdojnë normat aktuale të vdekshmërisë, është 74,4 vjet për meshkujt dhe 78,7 vjet për femrat, duke vazhduar trendin zbritës të vitit 2020, në krahasim me periudhën 2017-2019 (Figura 5).

Figura 5: Jetëgjatësia në lindje, sipas gjinisë, 2017-2021 (vite)



Burimi: INSTAT




Statistikat e shëndetësisë me në qendër fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë në Shqipëri, janë shumë të rëndësishme për marrjen e vendimeve dhe për planifikimin e shërbimeve shëndetësore.

Shkalla e aborteve

Abortet klasifikohen në dy kategori: aborte spontane dhe me kërkesë (shtatzënitë e ndërprera vullnetarisht e ligjërisht). Shkalla e abortit tregon numrin e shtatzënive të ndërprera ligjërisht e vullnetarisht, gjatë vitit, për 1.000 femra të grupmoshës përkatëse. Në vitin 2021, shkalla e abortit, për grupmoshën 15-19 vjeçe, ishte 0,2 (Figura 6), duke ndjekur një trend rënës krahasuar me vitet e mëparshme.


Figura 6: Shkalla e abortit te femrat 15-19 vjeçe (për 1.000 lindje të gjalla), 2017-2021 (numër)



Burimi: INSTAT; Instituti i Shëndetit Publik

Nga 2017 deri në 2021, abortet te femrat e grupmoshës 15-24 vjeçe, zinin afërsisht 16-18% të totalit të aborteve të kryera nga femrat në moshën riprodhuese (15-49 vjeçe), duke vazhduar trendin rënës prej vitit 2018 (Figura 7).

Figura 7: Përqindja e abortit te femrat 15-24 vjeçe (ndaj totalit të aborteve tek femrat 15-49 vjeçe), 2017-2021




Burimi: INSTAT; Instituti i Shëndetit Publik

Vdekjet nga vetëvrasja

Vetëvrasja te fëmijët dhe të rinjtë, mbetet një nga shkaqet e regjistruara të vdekjeve të kësaj grupmoshe.

Figura 8 tregon numrin e fëmijëve dhe të rinjve të vetëvrasarë për grupmoshën 10-24 vjeç. Të dhënat e vitit 2021, tregojnë pothuajse përgjysmimin e numrit në krahasim me vitet 2017-2018. Për sa i përket gjinisë, fëmijët dhe të rinjtë meshkuj, përgjithësisht janë më të prekur nga ky fenomen sesa femrat, me përjashtim të viteve 2017 dhe 2019.

Figura 8: Fëmijë dhe të rinj 10-24 vjeç të vetëvrasarë, sipas gjinisë, 2017-2021 (numër)




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

Vdekjet nga aksidentet rrugore

Vdekjet nga aksidentet rrugore përbëjnë gjithashtu një statistikë të rëndësishme të shëndetit publik, si një tjetër shkaktar i vdekjeve të adoleshentëve dhe të rinjtë. Faktorët që ndikojnë për përfshirjen në aksidente rrugore, lidhen jo vetëm me rrugët dhe mjetet motorike të pasigurta, por edhe me sjelljet e rrezikshme nga të rinjtë, si përdorimi i substancave të paligjshme apo alkoolit, shpejtësia, mosvënja e rripit të sigurimit apo helmetës, shpërqendrimi gjatë drejtimit, etj.

Gjatë viti 2021, si pasojë e aksidenteve rrugore humbën jetën 42 të rinj të grupmoshës 16-24 vjeç. Numri i meshkujve të përfshirë në këto aksidente, është tre herë më i lartë se ai i femrave (Figura 9).

Figura 9: Vdekjet nga aksidentet rrugore tek adoleshentët dhe të rinjtë 16-24 vjeç, sipas gjinisë, 2021 (numër)




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë



Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës e kryer çdo vit nga INSTAT pranë familjeve, siguron të dhëna mbi nivelin e jetesës, varfërinë relative dhe privimin material në familje. Sipas metodologjisë, kufiri i riskut për të qenë i varfër, llogaritet në bazë të konceptit relativ, pra i varfër në raport me të tjerët¹.

Në grupmoshën 0-17 vjeç, risku për të qenë i varfër, llogaritet si raport i numrit të individëve 0-17 vjeç, që ndodhen nën kufirin e riskut për të qenë të varfër, me numrin gjithsej të individëve 0-17 vjeç. Në vitin 2020, përqindja e fëmijëve (0-17 vjeç), që janë në risk për të qenë të varfër, sipas kufirit kombëtar të riskut për të qenë i varfër, paraqet një trend në rënie, duke u ulur me 1,3 pikë përqindje, në krahasim me vitin 2019 (Figura 10).

Figura 10: Përqindja e fëmijëve (0-17 vjeç) që janë në risk për të qenë të varfër, sipas kufirit kombëtar të riskut për të qenë i varfër, 2017-2020




Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, INSTAT

Përqindja e individëve në risk për të qenë të varfër sipas tipit të familjes, është një tregues që llogaritet si raport i numrit të individëve, anëtarë të familjeve me fëmijë në varësi, që jetojnë në risk për të qenë të varfër, ndaj totalit të individëve që u përkasin familjeve me fëmijë në varësi. Për vitin 2020, përqindja e individëve anëtarë të familjeve me fëmijë në varësi, në risk për të qenë të varfër, ka pësuar rënie me 1,3 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2019 (Figura 11).

1. INSTAT. Sipas metodologjisë për matjen e varfërisë, kufiri i rrezikut për të qenë i varfër, llogaritet në bazë të konceptit relativ dhe përcaktohet në 60 % të medianës së të ardhurave familjare disponibël, të ekuivalentuara duke përdorur shkallën e ekuivalentuar të modifikuar të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD).


Figura 11: Përqindja e individëve, anëtarë të familjeve me fëmijë në varësi, në risk për të qenë të varfër, 2017-2020



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, INSTAT

Përqindja e fëmijëve në risk për të qenë të varfër (varfëri relative) ndaj totalit të popullsisë që është në risk për të qenë të varfër, apo numri i individëve 0-17 vjeç që ndodhen nën kufirin e varfërisë relative në raport me numrin total të personave që ndodhen nën kufirin e varfërisë relative, ka pësuar rënie me 0,4 pikë përqindje për vitin 2020, krahasuar me vitin 2019 (Figura 12).

Figura 12: Përqindja e fëmijëve (0-17 vjeç) në risk për të qenë të varfër, ndaj totalit të popullsisë që janë në risk për të qenë të varfër, 2017-2020



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, INSTAT




Statistikat e arsimit për fëmijët dhe të rinjtë paraqesin të dhëna për pjesëmarrjen e vajzave dhe djemve, duke filluar nga arsimi parashkollor deri te arsimi i lartë, publik dhe jopublik, sipas niveleve që parashikohen nga sistemi zyrtar në vend për arsimin.

Sistemi arsimor në vend, kërkon që e gjithë popullsia banuese të përfundojë arsimin nëntëvjeçar, duke përfshirë këtu pesë vitet e ciklit të ulët (klasa 1-5) dhe katër vite në ciklin e lartë (klasa 6-9), si pjesë e arsimit bazë.

Për të treguar nivelin e përgjithshëm të pjesëmarrjes në arsim në një nivel të caktuar, përdoret Raporti Bruto i Regjistrimit (GER), i cili është numri i të regjistruarve në një nivel të caktuar arsimit, pavarësisht nga mosha, e shprehur si përqindje e popullsisë zyrtarisht në moshë shkollore, që i korrespondon të njëjtit nivel arsimit.

Duke analizuar raportin bruto të regjistrimeve, sipas nivelit arsimor, gjatë vitit shkollor 2021-22, vihet re se rreth 83,1% e djemve dhe 81,1% e vajzave, ishin regjistruar në kopshte. Niveli i pjesëmarrjes bruto në arsimin e detyrueshëm, është 98,7% për djemtë dhe 92,7% për vajzat. Edhe pjesëmarrja në nivelin e mesëm të studimeve, ishte më e lartë për djemtë se për vajzat, përkatësisht 98,7% dhe 89,9% (Figura 13).

Figura 13: Raporti bruto i regjistrimeve, sipas niveleve arsimore dhe gjinisë, 2021-2022




Burimi: INSTAT; Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Treguesi tjetër i rëndësishëm lidhur me pjesëmarrjen në arsim, është Raporti Neto i Regjistrimit (NER), i cili llogaritet vetëm për arsimin parauniversitar. NER-i tregon shkallën e mbulimit në një nivel të caktuar të arsimit të fëmijëve, që i përkasin grupmoshave zyrtare që korrespondojnë me nivelin përkatës të arsimit.

Për vitin 2021-22, u regjistruan në arsimin bazë 9-vjeçar 92% e nxënësve të grupmoshës 6-14 vjeç, në krahasim me popullsinë përkatëse (të grupmoshës 6-14 vjeç), përkundrejt 96,5% në vitin shkollor 2017-2018 (Figura 14).


Figura 14: Raporti neto i regjistrimeve në arsimin bazë 9-vjeçar, sipas gjinisë, 2017-2021²



Burimi: INSTAT; Ministria e Arsimit dhe Sportit

Pjesëmarrja sipas gjinisë në ciklet arsimore, tregon për ekzistencën e diferencave gjinore në nivelet e ndryshme të arsimit. Ka një pjesëmarrje më të lartë të djemve krahasuar me vajzat në arsimin parauniversitar, si në atë bazë, ashtu edhe në atë të mesëm. Kjo reflektohet edhe tek indeksi i barazisë gjinore (Ilogaritur mbi GER), që për arsimin bazë 9-vjeçar është 0,94 dhe për arsimin e mesëm 0,91 (Figura 15).

Figura 15: Indeksi i Barazisë Gjinore (mbi GER), 2021-22 (numër)




Burimi: INSTAT; Ministria e Arsimit dhe Sportit

Gjatë vitit shkollor 2020-21, në arsimin bazë u diplomuan rreth 32 mijë nxënës, nga të cilët 52,9% djem dhe 47,1% vajza. Po në këtë vit shkollor, në arsimin e mesëm u diplomuan rreth 31 mijë nxënës, ku vihet re një ulje e lehtë e numrit të nxënësve që marrin diplomë të arsimit të mesëm krahasuar me vitin paraardhës. Nxënësit e diplomuar në arsimin e mesëm sipas gjinisë, ndahen në 47,3% djem dhe 52,7% vajza, siç tregohet edhe në Figurën 16.

2. Shënim: Viti i referohet vitit shkollor 2021-2022.

Figura 16: Numri i nxënësve të diplomuar në arsimin bazë dhe të mesëm, sipas gjinisë, viti shkollor 2020-2021




Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Përfundimi i arsimit të mesëm, edhe pse nuk garanton pajisjen me të gjitha aftësitë e nevojshme në jetë, u jep të rinjve përparësi në tregun e punës, në krahasim me të rinjtë që braktisin shkollën.

Përqindja e të rinjve 20-24 vjeç që kanë përfunduar arsimin e mesëm në vitin 2021, arrin 83% nga 78% në vitin 2017, me një diferencë të dukshme gjinore në favor të femrave (Figura 17).


Figura 17: Përqindja e të rinjve (20-24 vjeç), që kanë përfunduar arsimin e mesëm, sipas gjinisë, 2017-2021



Burimi: Anketa e Forcës së Punës, INSTAT

Nga ana tjetër, përqindja e të rinjve 18-24 vjeç që kanë përfunduar arsimin bazë dhe nuk vazhdojnë shkollimin apo trajnimin, ndaj të rinjve të tjerë të së njëjtës grupmoshë, rezultoi 17,4% për vitin 2021, duke kthyer trendin zbritës të këtij treguesi që prej vitit 2017 (Figura 18). Në krahasim me vitin 2020, ky tregues për meshkujt u rrit me 2,1 pikë përqindje kurse për femrat me 1,6 pikë përqindje.

Figura 18: Përqindja e të rinjve (18-24 vjeç) që largohen para kohe nga shkollimi dhe trajnimi sipas gjinisë, 2017-2021



Burimi: Anketa e Forcës së Punës, INSTAT



Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të jetojnë në familje, qoftë ajo biologjike apo kujdestare (nëse nuk kanë familje ose nëse rrezikohen në familjen e tyre). Kjo e drejtë përcaktohet në traktatet përkatëse ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara dhe Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përfshirë Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Kartën Sociale Evropiane të rishikuar, si dhe Kartën e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian.


Kujdesi alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror

Treguesit në këtë seksion u referohen fëmijëve pa kujdes prindëror, që përfitojnë nga shërbimet e kujdesit alternativ. Përkufizimet për këta tregues, bazohen te Neni 24 i Ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe Neni 31 i Ligjit 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Kujdesi alternativ ushtrohet në rastet kur prindërit e kanë të pamundur të sigurojnë përkujdesje dhe edukim për fëmijët e tyre. Fëmija në kujdes alternativ, mund të jetë vendosur në njërin nga dy format e kujdestarisë: familjare ose institucionale.

Në fund të vitit 2021, 928 fëmijë të grupmoshës 0-17 vjeç janë në kujdes alternativ, ku krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka një rënie me 5% (Figura 19).


Figura 19: Numri i fëmijëve 0-17 vjeç në kujdes alternativ, në fund të vitit, 2017-2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

Gjatë viteve të fundit, përqindja e fëmijëve 0-17 vjeç në familje kujdestare dhe birësuese ndaj totalit të fëmijëve në kujdes alternativ, ka pësuar një rritje të ngadalshme, por sistematike (Figura 20), ku kontributi më i madh vjen nga numri i fëmijëve në familjet kujdestare.

Figura 20: Raporti i fëmijëve 0-17 vjeç në familje kujdestare dhe të birësuar, ndaj totalit të fëmijëve në kujdes alternativ, 2017-2021




Burimi: INSTAT; Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

Fëmijët në familje kujdestare

Procedurat e vendosjes së fëmijëve pa kujdes prindëror, në familjet kujdestare, rregullohen me VKM-në Nr. 149, datë 13.03.2018, “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”.

Në fund të vitit 2021, numri i fëmijëve 0-17 vjeç në familje kujdestare ishte 370, ku 192 ishin djem dhe 178 vajza. Krahasuar me vitin 2020, ky tregues është rritur me rreth 2,5%, ndërsa krahasuar me vitin 2017, rritja arrin në 33% (Figura 21).


Figura 21: Numri i fëmijëve 0-17 vjeç, pa kujdes prindëror, të vendosur në familje kujdestare sipas gjinisë, 2017-2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

Raporti i fëmijëve 0-17 vjeç me aftësi të kufizuar në familje kujdestare në fund të vitit 2021, ndaj totalit të fëmijëve në familje kujdestare në fund të vitit, është 4,3%. Ky raport ka arritur duke u rritur nga viti 2018, kur shënonte vetëm 2% (Figura 22).

Figura 22: Raporti i fëmijëve 0-17 vjeç me aftësi të kufizuar ndaj totalit të fëmijëve në familje kujdestare në fund të vitit, 2017-2021 (përqindje)



Burimi: INSTAT; Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

Gjatë vitit 2021, numri i fëmijëve 0-17 vjeç që kanë hyrë në shërbimin e kujdestarisë ishte 6% më shumë se një vit më parë, por pothuajse sa gjysma (48%) e hyrjeve të vitit 2019 (Figura 23).

Figura 23: Numri i fëmijëve 0-17 vjeç që kanë hyrë në familje kujdestare gjatë vitit, 2017-2021




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

Fëmijët në qendra me shërbim rezidencial

Qendrat me shërbim rezidencial, janë institucione të kujdesit shoqëror, që ofrojnë shërbime për kategoritë e fëmijëve në nevojë. Aktualisht, rrjeti i Institucioneve Rezidenciale të Kujdesit për Fëmijët, përbëhet nga 9 institucione publike dhe 18 qendra rezidenciale jopublike.

Gjatë vitit 2021, rreth 539 fëmijë të grupmoshës 0-17 vjeç, kanë marrë shërbime në qendra rezidenciale: shtëpi fëmijësh dhe qendra zhvillimi. Siç tregohet edhe nga Figura 24, trendi ndër vite është zbritës.


Figura 24: Numri i fëmijëve 0-17 vjeç në qendra me shërbim rezidencial në fund të vitit, 2017-2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

Rreth 51% e fëmijëve që kanë përfituar nga këto shërbime, u përkasin qendrave rezidenciale publike. Përqindjen më të madhe të numrit të fëmijëve që kanë marrë shërbime në këto qendra, e zë grupmosha 6-15 vjeç me rreth 54% (Figura 25).


Figura 25: Numri i fëmijëve 0-17 vjeç që kanë marrë shërbime rezidenciale, sipas gjinisë dhe grupmoshës, 2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

Hyrjet e fëmijëve në qendra rezidenciale gjatë vitit 2021, janë më të vogla krahasuar me një vit më parë, 61 kundrejt 88 (Figura 26)³.


Figura 26 : Numri i fëmijëve 0-17 vjeç, që kanë hyrë në qendra rezidenciale për fëmijë gjatë vitit, 2017-2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

Nga analiza e të dhënave për vitin 2021, për qendrat rezidenciale shtëpi fëmijësh, vihet re se për fëmijët meshkuj ka një numër më të madh hyrjesh në këto qendra, ndërsa grupmosha me numrin më të madh të hyrjeve, është 0-3 vjeç (Figura 27).

Figura 27: Numri i fëmijëve 0-17 vjeç që kanë hyrë në qendra rezidenciale shtëpi fëmijësh sipas gjinisë dhe grupmoshës, 2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror


3. Shënim. Këto shifra nuk përfshijnë transferimet e fëmijëve nga një qendër në tjetrën.

Birësimet

Procedurat e birësimit të fëmijëve në Shqipëri, janë rregulluar me Ligjin Nr. 9695, datë 19.3.2007, “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”.

Gjatë vitit 2021, janë birësuar një numër më i ulët fëmijësh, duke regjistruar rreth 27% fëmijë më pak në krahasim me vitin 2020. Kjo rënie është ndier te të dyja gjinitë, me përkatësisht 33% më pak meshkuj dhe 18% më pak femra (Figura 28).

Figura 28: Numri i fëmijëve 0-17 vjeç të birësuar gjatë vitit, sipas gjinisë, 2017-2021



Burimi: Komiteti Shqiptar i Birësimeve; Ministria e Drejtësisë




Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale për fëmijët, pasqyrojnë të dhëna lidhur me fëmijët e përfshirë në sistemin e drejtësisë, që mund të jenë viktimat/të dëmtuar të veprave penale, viktimat ose viktimat të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore, të dyshuar nga policia apo të pandehur për vepra penale, si dhe të dënuar nga gjykata me masa alternative apo heqje lirie. Për statistikën e krimeve, të dhënat mbledhen dhe raportohen nga policia, prokuroria, gjykatat, burgjet dhe Ministria e Drejtësisë.

Fëmijët viktimat të veprave penale

Të dëmtuarit (viktimat) e veprave penale, i referohen fëmijëve (0-17 vjeç), të dëmtuar nga kryerja e një veprave penale. Përgjatë pesë viteve të fundit, 2017-2021, vihet re një trend në rënie i fëmijëve të dëmtuar (viktimat) të veprave penale, më i shprehur në vitin 2020. Në vitin 2021, norma e fëmijëve 0-17 vjeç viktimat të veprave penale (për 100.000 fëmijë), ka shënuar vlerën 198 (Figura 29). Të dhënat në vlerë absolute gjenden tek Shtojca.

Figura 29: Norma e fëmijëve (0-17 vjeç) viktimat të veprave penale (për 100.000 fëmijë), 2019-2021 (numër)




Burimi: INSTAT; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Fëmijët viktimat dhe viktimat të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore

Viktimat apo viktimat e mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore, identifikohen nga strukturat e specializuara. Fatkeqësisht, edhe fëmijët janë viktimat të këtij fenomeni.

Figura 30, tregon numrin e fëmijëve 0-17 vjeç viktimat dhe viktimat të mundshme të trafikimit, ndaj totalit të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit për vitet 2019-2021. Ky raport ka arritur në rritje gjatë kësaj periudhe, duke arritur në 70% për vitin 2021, krahasuar me 65% në vitin 2019.


Figura 30: Raporti i fëmijëve (0-17 vjeç) viktima dhe viktima të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore, 2019-2021



Burimi: INSTAT; Ministria e Brendshme

Ndër fëmijët 0-17 vjeç viktima dhe viktima të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore, në vitin 2021, 46% e tyre janë femra. Ky raport ka ardhur duke rënë në krahasim me vitet e mëparshme, ku femrat zinin gati më shumë se dy të tretat në vitin 2019 (Figura 31).

Figura 31: Raporti mes femrave dhe meshkujve 0-17 vjeç viktima dhe viktima të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore, 2019-2021




Burimi: INSTAT; Ministria e Brendshme

Fëmijët e dyshuar për vepra penale

Çdo fëmijë ka nevojë për mbrojtje edhe kur dyshohet nga policia për kryerjen e veprave penale. Statistikat në këtë fushë ndihmojnë për garantimin e të drejtave dhe plotësimin e nevojave të tyre.

Në vitin 2021, numri i fëmijëve (9-17 vjeç) të dyshuar për kryerjen e veprave penale, shënoi vlerën 644 për 100.000 popullatë të kësaj grupmoshe, me një rënie të konsiderueshme në krahasim me vitin 2020. Për grupmoshën 9-14 vjeç, numri i të dyshuarve për vepra penale ishte 176 duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me një vit më parë (Figura 32).

Figura 32: Norma e fëmijëve (9-14 vjeç, 9-17 vjeç), të dyshuar për vepra penale (për 100.000 popullatë përkatëse), 2019-2021 (numër)




Burimi: INSTAT; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Fëmijët në institucionet e privimit të lirisë

Norma e fëmijëve në institucionet e privimit të lirisë, tregon numrin e fëmijëve të dënuar dhe në paraburgim në fund të vitit, në raport me 100.000 popullatë 14-17 vjeç. Në vitin 2021, vihet re një ulje e normës së fëmijëve në paraburgim, në krahasim me dy vitet paraardhëse 2020 dhe 2019. Për sa i përket normës së të dënuarve në institucionet e privimit të lirisë, ajo ka mbetur e njëjtë krahasuar me një vit më parë: 0,7, por gjithsesi më pak se viti 2019.

Figura 33: Norma e fëmijëve 14-17 vjeç në institucionet e privimit të lirisë, në fund të vitit (për 100.000 popullatë përkatëse), 2019-2021 (numër)




Burimi: INSTAT; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Fëmijët 14-17 vjeç të dënuar nga gjykatat e shkallës së parë

Në numrin e fëmijëve të dënuar për një vit, përfshihen fëmijët e dënuar me heqje lirie dhe të dënuarit me masa alternative nga gjykatat e shkallës së parë.

Numri i fëmijëve 14-17 vjeç të dënuar me heqje lirie nga gjykatat e shkallës së parë për vepër penale/kundërvajtje në vitin 2021, është rritur me 9,4% krahasuar me vitin 2019. Kurse në krahasim me vitin paraardhës, ky tregues është rreth tre herë më i lartë.

Figura 34: Numri i fëmijëve 14-17 vjeç të dënuar me heqje lirie nga gjykatat e shkallës së parë për vepër penale/kundërvajtje, 2019-2021




Burimi: Ministria e Drejtësisë

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, shpreh qartazi që, heqja e lirisë konsiderohet nga organet kompetente si masa e fundit e dënimit, duke u dhënë përparësi masave alternative të dënimit.

Figura 35, tregon numrin e fëmijëve 14-17 vjeç, të dënuar me masa alternative nga gjykatat e shkallës së parë për vepër penale/kundërvajtje, kundrejt totalit të fëmijëve 14-17 vjeç të dënuar nga gjykatat e shkallës së parë për periudhën 2019-2021. Një drejtësi miqësore ndaj fëmijëve, kërkon që ky raport të jetë sa më i lartë⁴.

Figura 35: Numri i fëmijëve 14-17 vjeç të dënuar me masa alternative, krahasuar me numrin gjithsej të fëmijëve 14-17 vjeç të dënuar nga gjykatat e shkallës së parë për vepër penale/kundërvajtje, 2019-2021



Burimi: Ministria e Drejtësisë

4. Për një interpretim më të saktë të këtyre treguesve është e nevojshme njohja e numrit të shmangieve të çështjeve, përpara se të arrijnë në gjykatën e shkallës së parë.




Politikat për të rinjtë në ditët e sotme, synojnë gjithnjë e më shumë rritjen e mundësive dhe fuqizimin e brezave të rinj që shprehen nëpërmjet aftësisë dhe përfshirjes në tregun e punës, duke sjellë barazi sociale, pavarësi ekonomike, rritje të vetëdijes shoqërore, dhe pjesëmarrje aktive në jetën sociale, ekonomike dhe politike.

Ky kapitull synon të bëjë një parashtrim të situatës së tregut të punës për fëmijët dhe të rinjtë, për të dhënë në mënyrë dinamike përfshirjen e grupmoshave përbërëse në punësim, ndërthurur me procesin e arsimit dhe trajnimit. Të dhënat mbi të cilat bazohen rezultatet e paraqitura, janë nxjerrë nga Anketa e Forcave të Punës kryer nga INSTAT, mbi popullsinë 15 vjeç e lart me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri.

Përqindja e fëmijëve 15-17 vjeç që angazhohen në tregun e punës në përputhje me legjislacionin në fuqi, pra që punojnë ose janë të gatshëm të punojnë dhe kanë kërkuar punë por nuk e kanë gjetur atë, ndaj numrit të fëmijëve të kësaj grupmoshe, cilësohet si shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës. Shkalla e pjesëmarrjes për fëmijët 15-17 vjeç është e ulët dhe në pesë vitet e fundit në nivelin 10% (Figura 36).

Figura 36: Shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës për grupmoshën 15 - 17 vjeç, sipas gjinisë, 2017-2021 (përqindje)




Burimi: Anketa e Forcës së Punës, INSTAT

Trendi rritës i viteve 2017-2019, pësoi një rënie të fortë prej 3% në vitin 2020, kur, si rezultat i kufizimeve pandemike, kishte një rënie të përgjithshme të treguesve të punësimit. Gjithsesi, në vitin 2021, shkalla e punësimit u ngrit mbi nivelet e mëparshme të periudhës para-pandemike, duke arritur 10,1%.

Rënia e përqindjes së fëmijëve të përfshirë në tregun e punës në vitin 2020, ishte më e ndjeshme për vajzat, për të cilat treguesi ra me 3,3 pikë përqindje, kundrejt rënies prej 2,6 pikë përqindje për djemtë. Përgjithësisht, në Shqipëri, pjesëmarrja e meshkujve është në mënyrë të konsiderueshme më e lartë se e femrave.

Për fëmijët e punësuar të moshës 15-17 vjeç, duket se angazhimi më i madh është në bujqësi. Rreth 80-85% e tyre punojnë në këtë sektor të ekonomisë (Figura 37). Shërbimet janë aktiviteti i dytë kryesor ku përfshihen fëmijët e kësaj moshe, me një peshë rreth 12% gjatë periudhës në studim, por me një pik rritjeje në vitin 2020 (ku arrin në 25%), që tregon se puna e fëmijëve në këtë vit, ka kaluar nga sektori i bujqësisë në sektorin e shërbimeve. Të dhënat e vitit 2021, tregojnë për një rivendosje të peshës së aktiviteteve sipas trendit të viteve të fundit, me një përfshirje prej 4% në sektorin e industrisë dhe një peshë të papërfillshme në ndërtim.


Figura 37: Struktura e punësimit sipas sektorëve kryesorë ekonomikë për grupmoshën 15 - 17 vjeç, 2017 -2021



Burimi: Anketa e Forcës së Punës, INSTAT

Përfshirja në tregun e punës për grupmoshat e reja, rritet me rritjen e moshës së anketuar (Figura 38). Shkalla e pjesëmarrjes për të tria grupmoshat (15-19, 15-24, 15-29 vjeç), u rrit në pesë vitet e fundit, gjë që tregon se janë rritur si numri i të punësuarve të rinjtë, ashtu edhe i punonjësve potencialë që janë të papunë, por kërkojnë punë në mënyrë aktive dhe janë të gatshëm të fillojnë punë nëse do të gjenin.


Figura 38: Shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës sipas grupmoshës, 2017-2021



Burimi: Anketa e Forcës së Punës, INSTAT

Dinamika e ndërveprimit midis pjesëmarrjes së hershme në tregun e punës dhe pjesëmarrjes në arsim ose trajnim, shprehet nga treguesit e punësimit, treguesit e papunësisë dhe treguesit e përfshirjes në tregun e punës. Për të rinjtë, procesi i arsimimit dhe formimit profesional, është parësor dhe i paraprin karrierës së mëvonshme profesionale, prandaj dhe sa më herët në moshë, aq më të zënë janë të rinjtë me procesin e mësimin dhe, si rrjedhim, ka më pak pjesëmarrje në tregun e punës (Figura 39).

Figura 39: Të rinjtë (15-29 vjeç) sipas statusit të arsimimit dhe punësimit, 2021



Burimi: Anketa e Forcës së Punës, INSTAT


Mosha 15-19 vjeç, në pjesën më të madhe, është ende e angazhuar në arsim dhe janë të paktë të rinjtë që ndjekin shkollën dhe njëkohësisht kryejnë ndonjë punë, si punë verore, në fundjavë, apo pas mësimin.

Mosha 20-24 vjeç, ka një ndarje më të barabartë midis punësimit dhe arsimit, por bie në sy një pjesë e të rinjve që nuk janë, as në punë, por as duke ndjekur shkollën apo ndonjë trajnim.

Ky grup është i konsiderueshëm edhe në grupmoshën 25-29 vjeç, që është e përfshirë më shumë në punësim dhe arsimit merr formën e një aktiviteti dytësor, si p.sh.: trajnime ose specializime profesionale, apo studime pasuniversitare. Në grupin e të rinjve që nuk janë në punë, por as duke ndjekur shkollën apo ndonjë trajnim, bie në sy një përqindje më e madhe e femrave në krahasim me meshkujt.

Kërkesa për punë rritet së bashku me shkallën e punësimit dhe pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, dhe të rinjtë shpesh kanë vështirësi për të gjetur punë. Përqindja e të rinjve që nuk janë aktualisht duke punuar, por që kërkojnë punë dhe janë të gatshëm ta fillojnë nëse u ofrohet, është e lartë në krahasim me pjesën e rritur të popullsisë (Figura 40). Rënia e shkallës së papunësisë fillon që pas moshës 25 vjeç, por edhe për grupmoshën 15-29 vjeç është pothuajse dyfishi i treguesit që i referohet popullsisë në moshë pune. Trendi rënës i këtij treguesi në vitet 2017-2019, përmbysset nga viti 2020, sidomos për grupmoshën më të re 15-24 vjeç.

Figura 40: Shkalla e papunësisë dhe papunësisë afatgjatë së të rinjve, 2017-2021




Burimi: Anketa e Forcës së Punës, INSTAT

Risku i papunësisë afatgjatë nuk duhet nënvlerësuar edhe kur vlerat nuk janë shumë të larta, duke qenë se mbartin fillesën e një situatë ekonomikisht inaktive, për shkak të dekurajimit. Pra, një i ri mund të dëshirojë të punojë, por nuk kërkon punë, sepse beson se nuk mund ta gjejë atë. Sa më i lartë ky tregues, aq më domethënës është lidhur me pamundësinë e ekonomisë për ta thithur atë pjesë potenciale të forcës së punës angazhuar në dije dhe aftësi bashkëkohore. Kjo tregon nevojën e stimulimit të ekonomisë, në mënyrë që të gjenerojë mundësi punësimi për brezin e ri, po aq sa dhe nxitje të aftësimit profesional apo subvencionim të sipërmarrjes së të rinjve.

Të rinjtë sipërmarrës, pra që janë të vetëpunësuar apo që kanë një biznes me punonjës me pagesë, zënë më pak se 20% të të punësuarve 15-29 vjeç dhe, nga pikëpamja gjinore, kjo përqindje është më e lartë për meshkujt se për femrat (Figura 41).

Figura 41: Të rinj (15-29 vjeç) të vetëpunësuar, sipas gjinisë, 2017-2021 (përqindje)




Burimi: Anketa e Forcës së Punës, INSTAT

Një tregues tjetër që hedh dritë mbi mundësitë e të rinjve që mund të stimulohen nëpërmjet përshtatjes së kushteve të punës, është përqindja e të rinjve me kontratë të përkohshme. Në vitin 2021, përqindja e të rinjve me kontratë të përkohshme, është përkatësisht 15% për grupmoshën 15-24 dhe 9% për grupmoshën 15-29 vjeç. Ky tregues është përgjithësisht më i lartë për të rinjtë 15-24 vjeç, duke qenë se kjo moshë është ende në proces shkollimi dhe mund të përshtatet më mirë me nevojat e kohës për studim.

Nga ana tjetër, grupmosha 15-24 vjeç ka më shumë gjasa të jetë e punësuar me kontratë pune të përhershme, por ndërsa për grupmoshën 15-24 vjeç përqindja e të punësuarve me kontratë të përkohshme është e ngjashme për të dyja gjinitë, në grupmoshën 15-29 vjeç ka një përqindje më të lartë meshkujsh se femrash, që punojnë me këtë lloj kontrate (Figura 42).

Figura 42: Të rinjtë e punësuar me kontratë të përkohshme, sipas grupmoshave dhe gjinisë, 2021



Burimi: Anketa e Forcës së Punës, INSTAT



Të dhënat mbi përdorimin e TIK-ut në familje dhe individë prodhohen nga Anketa e Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, i cili është një vërtetim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare dhe ka objekt të gjithë individët 16-74 vjeç me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri.


Anketa mundëson prodhimin e treguesve lidhur me përdorimin e internetit për të aksesuar informacionin përmes medias digjitale, lidhjen shoqërore nëpërmjet rrjeteve sociale, komunikimin me autoritetet publike, dhe zgjerimin e veprimtarisë së të mësuarit me anë të kurseve online. Një element tjetër i rëndësishëm i studiuar është edhe aftësia e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Përdorimi i TIK-ut

Të rinjtë janë grupi me përdorimin më të lartë të TIK-ut, në krahasim me çdo grupmoshë tjetër.

Aksesi në rrjetet sociale, shënon përqindjen më të lartë të përdorimit të internetit në krahasim me çdo aktivitet tjetër. Të rinjtë që e përdorin internetin për këtë qëllim, arrijnë në rreth 97% në vitin 2021, duke shënuar rritje gjatë periudhës 2019-2021, si për të dyja grupmoshat (16-24 dhe 16-29 vjeç) ashtu edhe për meshkujt e femrat (Figura 43).

Figura 43: Përqindja e të rinjve 16-24 dhe 16-29 vjeç, që përdorin internetin për të aksesuar rrjetet sociale, sipas gjinisë, 2019-2021




Burimi: Anketa e përdorimit të TIK, INSTAT

Përdorimi i internetit ka rritur edhe fuqizimin e të rinjve, duke mundësuar një pjesëmarrje më aktive në jetën shoqërore dhe politike. Në vitin 2021, rreth 45% e të rinjve shprehën opinionet e tyre për çështje të ndryshme të debatuar në rrjet (online), me një pjesëmarrje të njëjtë, si nga meshkujt, ashtu edhe nga femrat.

Një aspekt tjetër për të cilin përdorimi i TIK-ut munëson të dhëna, është të mësuarit nëpërmjet kurseve online dhe duke parë tendencën në vitet e fundit, ka gjasa të zhvillohet me hapa të shpejtë. Në vitin 2021, 11% e të rinjve 16-24 vjeç kryen kurse online duke përdorur internetin, kundrejt 4,2% në vitin 2019.

Në ditët e sotme, është i zakonshëm akses i informacionit përmes mediave digjitale. Të rinjtë që përdorin internetin për të lexuar faqet e lajmeve, revistave apo gazetave, përbëjnë gati 70% të grupmoshave përkatëse. Rritja e treguesit nga viti 2019 është e dukshme, ndërkohë që, gjatë vitit 2020, vihet re një përdorim më i ulët i mediave digjitale, që mund të jetë tregues i përdorimit alternativ të mediave vizive, si rezultat i qëndrimit në shtëpi gjatë pandemisë së COVID-19 (Figura 44).

Figura 44: Të rinjtë 16-24 dhe 16-29 vjeç që përdorin internetin për të lexuar faqet e internetit të lajmeve/revistave/gazetave, 2019-2021




Burimi: Anketa e përdorimit të TIK, INSTAT

Rritja e digjitalizimit të shërbimeve publike nga ana e administratës shtetërore apo shërbimeve arsimore, solli edhe rritjen e përdorimit të qeverisjes elektronike nga ana e të rinjve. Në vitin 2021, rreth gjysma e të rinjve e përdori internetin për të komunikuar me autoritetet publike, për shembull, për letërnjoftime, certifikata lindjeje, njoftime për zhvendosje, përfitime sociale, shërbime të shëndetit publik, informacione për regjistrimin në shkolla ose universitete, biblioteka publike etj.

Gjatë periudhës 2019-2021, përqindja e të rinjve që e kanë përdorur internetin për të komunikuar me autoritetet publike, është dyfishuar për të dyja grupmoshat e të rinjve, 16-24 dhe 16-29 vjeç, siç shihet edhe në Figurën 45.


Figura 45: Përdorimi i internetit për të komunikuar me autoritetet publike, 2019-2021



Burimi: Anketa e përdorimit të TIK, INSTAT

Për sa i përket gjinisë, ky tregues shfaq të njëjtën tendencë në rritje për të rinjtë 16-24 vjeç. Për shembull, femrat e kësaj grupmoshe zënë 24% të të anketuarve 16-24 vjeç, që raportojnë përdorimin e internetit për të komunikuar me autoritetet publike në vitin 2021, nga vetëm 13% në vitin 2019 (Figura 46).

Figura 46: Përqindja e të rinjve 16-24 vjeç që përdorin internetin për të komunikuar me autoritetet publike, sipas gjinisë, 2019-2021




Burimi: Anketa e përdorimit të TIK, INSTAT

Aftësitë teknologjike dhe kompjuterike

Aftësitë teknologjike apo kompjuterike, të cilat u referohen përdoruesve të rregullt të internetit për grupmoshat përkatëse gjatë tre muajve të fundit, kanë shënuar rritje për të dyja grupmoshat 16-24 vjeç dhe 16-29 vjeç (Figura 47).

Figura 47: Përqindja e të rinjve 16-24 dhe 16-29 vjeç, me të paktën një aftësi përdorimi të TIK-ut, 2019-2021




Burimi: Anketa e përdorimit të TIK, INSTAT

Përqindjet më të larta janë shënuar për aftësitë lidhur me: “transferimin apo kopjimin e materialeve/skedarëve”, “instalimin e softuerëve/aplikacioneve”, “krijimin e prezantimeve/dokumenteve, duke integruar tekste, piktura, tabela apo grafikë”, si dhe “përdorimin e programeve për të edituar foto, video, apo materiale audio”.

Përqindja e të rinjve që e përdorin internetin “për të krijuar kode në gjuhë programimi”, megjithëse e vogël, tregon një hap të rëndësishëm për zhvillimin e aftësive TIK. Për të rinjtë 16-24 vjeç, kjo përqindje rritet nga 3% në vitin 2019, në 13% në vitin 2021, ndërsa për grupmoshën 16-29 vjeç, rritja shkon nga 3%, në 19% gjatë së njëjtës periudhë (Figura 48).

Figura 48: Përqindja e të rinjve 16-24 dhe 16-29 vjeç sipas llojit të aftësive kryesore të TIK-ut, 2021



Burimi: Anketa e përdorimit të TIK, INSTAT

Shtojcë

Drejtësia

Fëmijë në kontakt me ligjin (numër)	2019	2020	2021
Fëmijë 0-17 vjeç viktima (të dëmtuar) të veprave penale, gjatë vitit	1226	1035	1129
Fëmijë 9- 17 vjeç të dyshuar për vepra penale, gjatë vitit	1337	3308	1940
Fëmijë 9- 14 vjeç të dyshuar për vepra penale, gjatë vitit	267	489	531
Fëmijë 14-17 vjeç në institucionet e privimit të lirisë të dënuar, në fund të vitit	4	1	1
Fëmijë 14-17 vjeç në institucionet e privimit të lirisë të paraburgosur, në fund të vitit	19	20	18

